


**EPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE SILVANA MERKO**

Nr. 11012 Rep.
Nr. 2001 Kol.



KONTRATE

**PER TRANSFERIMIN E PJESEVE TE KAPITALIT TE SHOQERISE ME
PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ITP-Infratransproject" Sh.p.k.**

Ne Tirane sot me date 12.12.2005 (dy mije e pese) ditën e hene para meje noteres Silvana Merko me adrese bulv. "Gjergj Fishta" (prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane) u paraqiten personalisht palet:

Nga njera ane:

Z. Faruk Kaba, i biri i Jusufit, lindur me 1945, banues ne Tirane identifikuar nga pasaporte personale me nr.Z0476762, ortak i shoqerise "ITP-Infratransproject" Sh.p.k., i cili ne vijim do te permendet Shitesi

Nga ana tjeter:

Shoqeria e se drejtes suedeze ÅF-Infrastruktur AB, 556185-2103, Box: 1310, 171 25 Solna perfaqesuar per nenshkrimin e kesaj kontrate nga z. Keivan Ashhami, ne baze te autorizimit te dates 12.12.2005, nga Prsidenti I shoqerise Åke Rosenius, bashkangjitur kesaj kontrate, i cili ne vazdim do te permendet Bleresi.

Te cilet ne baze marreveshjes midis paleve te dates se sotme kerkuan hartimin e kesaj kontrate per transferimin e pjeseve te kapitalit si me poshte vijon:

Me vendim te dates 12.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ITP-Infratransproject"shpk, vendim ky i marre me pjesemartjen e plote te pjeseve te kapitalit fillestar, eshte vendosur miratimi i transferimit dhe shitjes se nje pjese te pjeseve te kapitalit te zoteruara prej ortakut z.Faruk Kaba qe perbejne 49% te kapitalit te shoqerise baraz me 53.900 (pesedhete e tre mije e nente qind) leke ne vlere nominale ne favor te blesesit, shoqerise e se drejtes suedeze ÅF-Infrastruktur AB, perfaqesuar nga z. Keivan Ashhami.